

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga ushqimi i preferuar, te dëshira për ski/ Maran "i shqiptarizuar", zbulon përditshmërinë e tij
ADRESA	https://www.cna.al/sport/nga-pjata-e-preferuara-te-deshira-per-ski-maran-i-shqiptarizuar-zbulon-per-i474118
BURIMI	cna.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 13:35:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 13:23:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c50d7789692b91dc5889d63e6fcb9b0409d2de68b24675f67a58c7f3d6121231
TEKSTI	61327396e70f25dce1468cc904eeba45a667a119faebfab0dced1bf4433d1be5
PAMJA	a67b9ea1817a25bb7e1f01f2e77a3c963ff19fcca7bef7a9a04ea724ba64678f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3cfa83aac92d70b0ccf212845a4400bc622f4739204de156626d111eb78c329f
E MËPARSHMJA	788dadeef4b2eafd990e812581b7086233ee6a2e6f54499b55cefd9248579011
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3cfa83aac92d70b0ccf212845a4400bc622f4739204de156626d111eb78c329f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

Nga ushqimi i preferuar, te dëshira për ski/ Maran "i shqiptarizuar", zbulon përditshmërinë e tij



14 Shtator 2026, 15:23, Sport CNA



Nga rutina e mëngjesit dhe dashuria për natyrën, te familja, miqtë dhe ditët e lira; nga përshtypjet për Shqipërinë dhe mikpritjen shqiptare, te tavë dheu, "avash-avash" dhe vështirësitë me fjalën "përsëritje". Trajneri i Kombëtares shqiptare, Rolando Maran, rrëfen në një intervistë për "fshf.org" anën e tij më personale, duke folur për jetën e përditshme dhe muajt e parë në Shqipëri.

Maran tregon çfarë pëlqen më shumë në punën e tij, si e kalon një ditë perfekte kur është i lirë, çfarë e ka impresionuar më shumë te shqiptarët dhe cilat janë vlerat që dëshiron t'ua përcjellë edhe futbollistëve të Kombëtares. Një bisedë ndryshe me trajnerin kuqezij, mes futbollit, jetës, natyrës dhe disa fjalëve të para në shqip.

– Në çfarë ore zgjoheni zakonisht?

– Herët, zakonisht rreth orës 7:00, ndoshta edhe më herët, por ky është orari i zakonshëm në të cilin zgjohem.

– Cila është gjëja e parë që bëni në mëngjes?

– Kjo është e thjeshtë. Gjëja e parë që kërkoj është një hapësirë të lashtë. çfarëdo qoftë ajo. Ose hap një dritare. dal në tarracë apo në kopsht. por gjëja e parë që bëj është të dal në

një ambient të hapur.

– Në çfarë ore vini në Federatë?

– Menjëherë pas kësaj. Nuk kam një orar të përcaktuar, por pasi ha mëngjesin, nisem, bëj shëtitjen time deri këtu, arrij dhe filloj përgatitjet për këto ndeshje.

– Çfarë ju pëlqen më shumë nga puna juaj?

– Puna ime lind nga pasioni, ndaj është e qartë që, duke qenë një pasion, më pëlqen gjithçka. Gjithçka nisi që kur luaja futboll si fëmijë dhe përpigësja të bëhesha futbollist. Pastaj ia dola dhe tani jam trajner, në këtë rast jam trajner i Kombëtares. Kjo më mbush me krenari dhe, mbi të gjitha, bëj atë që më pëlqen. Nuk ka asgjë në punën time që nuk më pëlqen.

– Si është dita juaj perfekte kur jeni i lirë?

– Siç të thashë edhe më parë, e dua shumë natyrën dhe ambientin e hapur, ndaj dua të jem gjithmonë jashtë. Varet edhe nga stina. Nëse është dimër, kërkoj vende ku ka sa më shumë borë, sepse ndoshta mund të bëj edhe ski. Shëtitjet, familja, të kaloj kohë me miqtë, janë të gjitha gjëra që më bëjnë të lumtur.

– Pas pak kohësh në Shqipëri, çfarë ju ka surprizuar më shumë?

– Në fakt, nuk do të thoja se më ka surprizuar, por ka qenë një konfirmim, një konfirmim i mëtejshëm. Më kishin folur për mikpritjen tuaj dhe ju e keni tejkaluar atë që më kishin thënë. Duhet të jem i sinqertë: ndihem si në shtëpi, më keni bërë të ndihem si miku juaj prej gjithmonë. Për mua kjo është më shumë se një cilësi; është vërtet diçka befasuese.

– Cila është gjëja më "shqiptare" që keni mësuar?

– Nuk kam një të tillë. Dua të mësoj shumë gjëra. Tani është ende herët, sepse kam mësuar diçka dhe, nëse do të thosha tani se çfarë është, ndoshta do të gënjeja. Nuk më pëlqen të gënjej; më pëlqen të them gjërat e vërteta, ato që i ndiej vërtet.

– Çfarë ju pëlqen më shumë te shqiptarët?

– Ajo që kam vlerësuar shumë gjatë këtyre muajve është vendosmëria dhe forca me të cilën i bëni gjërat. Është një vlerë shumë e madhe. Dhe është diçka që dua t'ua transmetoj edhe lojtarëve kur të vijnë, sepse kjo është ADN-ja e futbollitit dhe e popullit shqiptar.

– Keni adoptuar ndonjë zakon shqiptar?

– Jo edhe aq shumë. Po studioj për t'u afruar gjithnjë e më shumë me ju. Dalëngadalë po përpigëm të kuptoj, sepse ka shumë gjëra të bukura, shumë aspekte, edhe në territorin tuaj, që më kanë ngjallur vërtet kureshtje.

– Cila pjatë shqiptare ju ka pëlqyer më shumë?

– Tavë dheu. Po, nëse e kam shqiptuar mirë... Madje është padyshim më e mirë sesa mënyra se si e shqiptova unë! Por më ka pëlqyer shumë.


– Cila është fjala juaj e preferuar në shqip?

– Për nga tingëllimi, më pëlqen të them "avash-avash". Jo për ndonjë arsye të veçantë, por sepse më pëlqen si tingëllon fjala.

– Po ajo që e keni më të vështirë ta shqiptoni?

– Ndoshta sepse te ne është shumë e lehtë të përhëndesësh me një "Ciao", ndërsa të përhëndesësh me "Përhëndetje" është pak më e komplikuar. Prandaj preferoj ta them në italisht, sepse është vërtet e vështirë në shqip.

Pastaj, versioni tjetër, "Çkemi?", sipas meje është edhe më i vështirë, kështu që për të heq dorë fare.





Të sugjeruara

Moment i vështirë për Ramos te Milan-i

Dinamo bën dy afrime në mbrojtje

"Lumë" golash para grumbullimit, shkëlqejnë legjionarët kuqezi

Viti i ri shkollor, Duka: Mësoni, ëndërroni dhe besoni te vetja. FSHF pranë jush me "Uniforma Ime"

Fund i çmendur dhe dramatik! Zhegrova shënon dopietë, por Juventusi humb pas 5 golave

Egnatia nuk është e pathyeshme, dopieta e Nikajt i jep fitoren e parë Elbasanit

Harry Kane nderon Bayern-in, fitore me vështirësi ndaj ekipit surprizë

Manchester City-Stoke: 4-1, Arsenal-Cardiff: 3-0, United-Cardiff: 2-0, Tottenham-Hull: 2-0

Manchester City mton derbin tate Haaland, United nuk i ben pune as karton i kuq

Barcelona me ecuri perfekte, vjen fitorja e pestë radhazi në La Liga

Dy gola, karton i kuq dhe kaos! Vllaznia nuk njeh fitore, humb ndaj Laçit

Kaos në Laç, arbitri jep karton të kuq dhe ndërpret ndeshjen

Rikthim në stol? Klubi i njohur tenton Piolin

Formula 1/ Antonelli ia del sërish, firon në Çmimin e Madh të Spanjës

Risi në sulm për Kombëtaren, Maran me mungesa të shumta

U largua nga Interi pas 28 vitesh, Ausilio behet gati për aventurën e re

Amorim në telashe, Milani nuk bind ende

Nga stadiumet te përvoja e tifozëve/ Shefi i operacioneve në UEFA flet për përgatitjet e EURO U-21

Dy miqësore për kuqezinjtë në muajin shtator

Fitorja e tretë radhazi ngjit Teutën në krye të renditjes


Duel me dy tablo, Milani shmang humbjen falë dopietës së Moreira

[editorial](#)

09:41 Editorial

Drejtesia shqiptare dhe katër të vërtetat që askush s'i thotë bashkë

CNA LIVESTREAM





Na ndiqni edhe në



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.